

S H E N I M E T S H P J E G U E S E

Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2 i permiresuar Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte te percaktuara ne SKK 2 te permiresuar. Rradha e dhenies se spjegimeve duhet te jete :

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënimet qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

A I Informacion i përgjithshëm

- 1 Kuadri ligjor: Ligjit 9228 dt 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- 2 Kuadri kontabel I aplikuar:Standartet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2)
- 3 Baza e pergatitjes se PF:Te drejttat dhe detyrimet e konstatuara.(SKK 1)
- 4 Parimet dhe karakteristikave cilesore te perdorura per hartimin e P.F:(SKK 1)
 - a)NJESIA EKONOMIKE RAPORTUESE ka mbajtur ne llogarine e saj aktivet,pasivet dhe transaksionet ekonomike te veta.
 - b)VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuese eshte e siguruar duke mos patur ne plan ose nevoje nderprerjen e aktivitetit te saj.
 - c)KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi nuk ka,ndersa midis te ardhurave dhe shpenzimeve ka vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.
 - d)KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e plote per te qene te qarta dhe te kuptushme per perdorues te jashtem qe kane njohuri te pergjithshme e te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.
 - e)MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane hartuar vetem per zerat materiale.
 - f)BESUSHMERIA per hartimin e Pasqyrave Financiare eshte e siguruar pasi nuk ka gabime materiale duke zbatuar parimet e meposhtme:
 - * Parimin e paraqitjes me besnikeri.
 - * Parimin e perparise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore
 - * Parimin e paanshmerise pa asnje influencim te qellimshem
 - * Parimin e maturise pa optimizem te tepruar,pa nen e mbi vleresim te qellimshem.
 - * Parimin e plotesise duke paraqitur nje pamje te vertete e te drejte te PF.
 - * Parimin e qendrushmerise per te mos ndryshuar politikat e metodat kontabel
 - * Parimin e krahasueshmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

A II Politikat kontabël

Per percaktimin e koston se inventareve eshte zgjedhur metoda "FIFO" (hyrja e pare,dalja e pare SKK 4)

Vleresimi fillestar I nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njohje si aktiv ne bilanc eshte vleresuar me kosto.(SKK 5;11)

Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua,kostot e huamarrjes (dhe interesat) eshte metoda e kapitalizimit me koston e aktivitetit per periudhen e investimit.(SKK 5)

Per vleresimin e mepasshem I AAM eshte zgjedhur modeli I koston duke I paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar.(SKK 5)

Per llogaritjen e amortizimit te AAM (SKK 5) njesia jone ekonomike ka percaktuar si metode te amortizimit te ndertesave metoden lineare dhe per AAM te tjera metoden e amortizimit mbi bazen e vleres se mbetur ndersa normat e amortizimit jane perdorur te njellojta me ato te sistemit fiskal ne fuqi dhe konkretisht:

Per ndertesat me 2% te vleres se mbetur

Komputera e sisteme informacioni me 25% te vleres se mbetur ,pajsje zyre 20% te vleres se mbetur

Te gjitha AAM te tjera me 15% te vleres se mbetur dhe mjetet e transportit 10% te vleres se mbetur

Per llogaritjen e amortizimit te AAJM (SKK 5) njesia ekonomike raportuese ka percaktuar si metode te amortizimit metoden lineare me normen e amortizimit me 10% ne vit.

B Shënimet qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare

1 Aktivet monetare

Gjendja e mejeteve monetare ne shoqeri perbehen nga :

- * Banka 69,080,262 leke
- * Arka - leke

2 Te drejta te arketueshme

- * Te tjera shteti debitor per t.v.sh.ne shumen 454182 leke, shteti tatim mbi fitimin ne shumen 0 leke si dhe klientet ne shumen 941,753,521leke dhe te tjere ne shumen 20,002,746 leke.

3 Inventaret

- * Gjendja e inventarit me daten 31.12.2017 este ne shumen 52,300,786 leke.(bashkangjitur inventari fizik) inventar i imet ne shumen 2,747,358

4 Aktivet afatgjata materiale

- * Aktivet Afat Gjata Materiale jane ne shumen 3,804,416,128 leke (vlera historike), blerjet e realizuara gjate vitit ushtrimor jane ne shumen 263,927,524 leke (bashkangjitur pasqyra)

5 Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata

- * Detyrimet ndaj punonjesve ne shumen 0 leke, ndaj sigurimeve shoqerore ne shumen 3,794,476 leke, TAP 386,675 leke, Tatim ne burim 414,687.ndaj shtetit tatim Tvsh ne shume 0 leke ndersa pjesa tjeter qe paraqitet ne pasqyrat financiare ehte e pa kuadruar, si dhe detyrimet ndaj furnitoreve ne shumen 782,454,577 leke dhe kreditore te tjere 24,975,573
- * Ne deyrimet jane dhe ndaj kreditoreve ne shumen 1,449,536,157 leke shtuar nga investimet e reja(KFW).

6 Kapitali, rezervat dhe fitimet e realizuara.

- * Kapitali i nenshkruar dhe i paguar ne shumen 377,830,937leke
- * Rezervat e shoqerise jane ne shumen 187,021,984 leke.
- * Humbja e mbartur ne vite 446,087,852-leke
- * Fitimi neto i realizuar gjate vitit ushtrimor 2018 eshte ne shumen 768,360 leke.

7 Te ardhurat

- * Realizimi i te ardhurave gjate vitit 2018 eshte ne shumen 396,478,081 leke nga shitja e ujit dhe sherbimi I kanalizimeve, nga lidhja e kontratave te reja etj 19,047,192 leke

8 Shpenzimet

- * Shpenzimet perbehen nga lenda e pare e konsumuar per shitje ne shumen 415,525,273 leke nga shpenzimet per pagat ne shumen 157,307,859 leke, nga shpenzimet per sigurimet shoqerore ne shumen 26,523,208 leke, nga shpenzimet per amortzimin e aktiveve ne shumen 70,559,147 leke si dhe nga shpenzime te tjera te shfrytezimit ne shumen 58,779,044 leke.(per keto shpenzime eshte pasqyra bashkangjitur bilancit).

- 9 Bilanci ka te bashkangjitur edhe pasyrat e fluksit te pareve, pasqyren e levizjes se kapitalit, pasqyren e Gjendjes se aktiveve te qendueshme se bashku me menyren e llogaritjes se amortzimit.

C Shënime të tjera shpjeguese


Ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat behen rregullime apo ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat nuk behen rregullime nuk ka.
Gabime materiale te ndodhura ne periudhat kontabel te meparshme te konstatuara gjate periudhes raportuese dhe korigjime nuk ka.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Flamur Zaimi

Per Drejtimin e Njesise Ekonomike

Piro Ndreu



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Fier”.

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2018

Ujësjetllës Kanalizime Sh.a.Fier

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

(të Ushtrimit të mbyllur më datë 31.12.2018)

30 Mars 2019

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Fier”.

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2018

“Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Fier është Shoqëri aksionere, themeluar me vendim të Gjykatës nr. 24510 dt 11.10.2000 , regjistruar në Degën e Tatimeve Fier me nipt J63423411D. Veprimtaria e shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 “Për Shoqëritë Tregtare”, nga statuti i saj dhe Legjislacioni në fuqi.

Selia e shoqërisë është në lagjen:“ 1 Maj” Fier .

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë “U.K.” sh.a.Fier është prodhimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm,grumbullimin,largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Shoqëria zhvillon aktivitetin me aktive në pronësi të Pushtetit Vendor sipas VKM nr.63 datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm,grumbullimin,largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, të cilat përbëhen nga ndërtesa e instalime te përgjithshme, makineri-pajisje, mjete transporti, mobilje orendi dhe pajisje informatike.

Shoqëria “U.K.F” sh.a. ***administrohet*** nga Keshilli Administrativ me Administrator të shoqërisë z. Piro Ndreu, i cili ka kompetenca për drejtimin e saj mbi bazën e statutit.

Politikat kontabël janë aplikuar sipas parimit të qëndrueshmërisë së metodave.

Pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve është sipas natyrës dhe është hartuar sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara .

Pasqyra e fluksit të parasë është paraqitur me metodën indirekte.

Kërkesat për arkëtim dhe detyrimet janë paraqitur me vlerën neto të realizueshme.

Gjëndjet financiare janë shprehur në lekë. Veprimet janë regjistruar në mënyrë kronologjike në librat e kontabilitetit. Çdo veprim është mbështetur në dokumenta justifikues dhe dokumenta kontabël të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në kontabilitet janë regjistruar të gjitha transaksionet financiare që i takojnë periudhës ushtrimore 2018, dhe që ndikojnë në rezultatin e këtij ushtrimi. Veprimet janë ngurtësuar me 31 Dhjetor 2018.

Aktivitet e qëndrueshme të trupëzuara paraqiten në bilanc me koston historike minus amortizimin e akumuluar .

Amortizimi është llogaritur në bazë grupimi për Aktivitet e qëndrueshme sipas Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 të ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”

Stoku është vlerësuar me koston e marrjes.

Shpenzimet janë kontabilizuar në bazë të dokumentave justifikuese.

Të ardhurat janë kontabilizuar në bazë të faturave tatimore.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Fier”.

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2018

Zërat e bilancit paraqiten:

Aktive monetare për 69,080,262 lekë, paraqesin mjete në :

- Banka per 69,080,262 lekë
- Arka per 0 lekë

Aktivitet monetare paraqesin mjetet monetare në arkë e bankë në datën 31.12.2018. Shoqeria operon me disa banka, të gjitha veprimet janë regjistruar në ditarët përkatës.

Aktivitet financiare afatshkurtra në vlerën 962,210,449 lekë detajohen si më poshtë:

Llogaria **Klientë** në vlerë 941,753,521 lekë paraqet vlerën faturave të paarkëtuara, kjo llogari është e analizuar sipas klientëve dhe nuk rakordon me llogarinë sintetike të tyre të ndarë sipas kategorive janë :

- Familjare 588,068,768 lekë
- Institucione 32,908,620 lekë
- Kopmani 57,928,029 lekë
- Industri 400,873,464 lekë
- Totali 1,079,778,881 lekë**

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se janë ulur klientët debitorë në vlerën 17,315,007 lekë duke e krahasur me vitin 2017.

Nga të dhënat e mësipërme rezulton një diferencë në llogarinë Klientë të paraqitura në pasqyrat financiare dhe asaj sintetike “Al-Billing”. Kjo diferencë vjen nga kalimi jo i saktë i të dhënave nga programi Komtel në Al-Billing, tjetër arsye të diferencës mund të jetë ndonjë gabim në shumën e faljes së detyrimeve me ligj në vitin 2011 si dhe mos shkarkimi i klientëve që derdhin në bankë për mungesë të numrit të kontratës.

- **Të tjera kërkesa debitorë** për 20,002,746 lekë, ku paraqit debitorë të ndryshëm (furnitorë të cilët dalin në pozicionin debitorë raporte mjeksore mbi 14 ditë që duhet të likujdojnë Sigurimet Shoqërore.)

Në llogarinë “**Lendë të para**” për 52,300,786 lekë, shoqëria ka paraqitur gjendjen e inventarit në magazinë, i cili përputhet me inventarin fizik në datë 31 Dhjetor 2018, ndërsa në llogarinë “**Mallra**” për 2,747,358 lekë paraqiten gjendjet e inventarit të imët në përdorim më datë 31 Dhjetor 2018.

Stoku evidentohet në llogari sipas metodës me inventarizim të vazhduar. Ato justifikohen me dokumenta dhe janë regjistruar në shpenzime me koston e blerjes.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Fier”.

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2018

Inventari fizik i gjëndjes së mallrave është kryer nga shoqëria në fund të ushtrimit i cili rakordon me gjëndjen e paraqitur në bilanc.

Aktive afatgjata materiale

Shoqëria ka një vlerë neto aktivesh të qëndrueshme për 3,001,357,270 lekë cila përbëhet si më poshtë:

<u>Pershkrimi</u>	<u>Viti 2018</u>	<u>Viti 2017</u>
Toka	40,488,775	40,488,775
Ndërtime e instalime të përgjithshme	2,517,165,744	2,306,034,918
Makineri dhe Pajisje	66,558,906	75,613,624
Mjete Transporti	42,388,967	47,098,853
Pajisje Zyre e informatike	4,758,822	5,789,771
<u>Aktive në proces</u>	<u>329,996,057</u>	<u>587,247,581</u>
Totali	3,001,357,270	3,062,273,252

A.A.M gjatë ushtrimit janë ulur me 1,342,511 lekë me vlerë të mbetur si më poshtë :

- Paisje zyre +informatike janë ulur me 1,342,511 lekë

Shtesat e AQT-ve rezultojnë në zërat:

- *Ndërtesa* janë shtuar për 257,251,524 lekë të cilat kanë qënë të regjistruara në kontabilitet si investimeve në proces që nga viti 2011, të investuara nga kredia e IDA BW .
- *Makineri e pajisje* janë shtuar për 6,068,000 lekë me kosto blerje. Ato përfaqësojnë kryesisht pompa dhe elektropompa të blerë gjatë vitit nga vetë shoqëria .
- *Pajisje zyre dhe informatike* janë shtuar me 608,000 lekë, me kosto blerje ato përfaqësojnë pajisjet elektronike të blera gjatë vitit etj.

Amortizimi është llogaritur në masën 70,559,147 lekë, është kontabilizuar në shpenzime për të njëjtën shifër dhe nuk kalon kufijtë e përcaktuar nga fisku. A.A.M justifikohen me inventar fizik të kryer në fund të ushtrimit.

DETYRIMET DHE KAPITALI

“Kapitalet e veta” paraqiten me vlerë 377,830,937 lekë.

“Kapitali i nënshkruar” i shoqërisë është 377,830,937 lekë, e cila përputhet me ekstraktin historik të shoqërisë të nxjerrë nga QKB.

“Primi i lidhur me kapitalin” paratitet me vlerën 19,807,285 lekë.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Fier”.

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2018

“Rezerva të tjera” paraqitet në vlerën 187,021,984 lekë.

“Fitimet e pashpërndara” në shumën (446,087,852,572) lekë.

“Fitimi/humbje i ushtrimit” sipas bilancit kontabël paraqitet për 768,360 lekë.

Detyrimet afatshkurtra

Detyrimet me vlerë 812,364,388 lekë përfaqësojnë:

<u>Pershkrimi</u>	<u>Viti 2018</u>	<u>Viti 2017</u>
Furnitorë për blerje e shërbime	782,454,577	786,453,649
Personeli	0	0
Detyrimet tatimore	4,595,838	9,039,186
Hua të tjera	24,975,573	23,353,237
Totali	812,364,388	819,316,092

Furnitorët për 782,454,577 lekë paraqesin vlerën e faturave të palikujduara, kjo llogari është e analizuar sipas furnitorëve dhe rakordon me llogarinë sintetike të tyre, pjesën më të madhe e zë energjia elektrike me 551,544,721 lekë.

Personeli për 0 lekë paraqet detyrimin e shoqërisë për pagat e punonjesve për muajin Dhjetor 2018. Listëpagesat janë përpiluar saktë, pagesat janë kryer në kohë dhe nëpërmjet bankës dhe muaji Dhjetor 2018 është paguar brënda vitit .

Detyrimet tatimore paraqesin:

- **Tatim në burim 414,687 lekë.**
- **Tatim page** për 386,675 lekë paraqet detyrimin e shoqërisë për tatimin mbi pagën për muajin Dhjetor 2018.
- **Sigurimet shoqërore** për 3,794,476 lekë. Ato paraqesin detyrimin e shoqërisë për sigurimet e muajit Dhjetor 2018. Listëpagesat janë llogaritur saktë dhe derdhur në kohë në bankë.
- **Hua afatgjata** për 1,449,536,157 lekë paraqet hua në monedhë të huaj marrë sipas projektit “Projekti Rajonal i Ujësjetllës Kanalizimeve” financuar nga Banka Botërore nën projektin e kredisë IDA dhe nga programi i Infrastrukturës Bashkiake II të KfW.

V. Verifikimi i llogarisë Fitime/Humbje

Shpenzimet dhe të ardhurat janë grupuar si më poshtë:

<u>Te ardhura</u>	<u>Viti 2018</u>	<u>Viti 2017</u>
Nga shitja e mallrave	396,478,081	381,813,685
Nga lidhje kotrate e të tjera	16,827,200	10,626,262
I Totali (Afarizmi)	413,305,281	392,439,947

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Fier”.

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2018

<u>Shpenzime</u>		
Materiale të konsumuara	45,670,700	38,567,966
Shpenzime për energji elektrike	162,383,232	191,882,420
Gjoha dhe dëmshpërblime	13,911,333	149,767
Shpenzime të tjera	41,749,444	34,656,754
Pagat e personelit	157,307,859	151,970,732
Shpenzime të tjera për personelin	2,707,500	237,900
Shpenzimet për sigurime	26,523,208	27,957,594
<u>Amortizim</u>	70,559,147	49,829,258
Totali i shpenzimeve	520,812,423	495,102,624

<u>Te ardhura dhe shpenzime te tjera</u>	<u>Viti 2018</u>	<u>Viti 2017</u>
Te ardhura nga kamatë vonesa	13,315,685	10,356,125
Te ardhura nga rimarrja e grantit	107,163,182	94,116,800
Te ardhura nga interesat dhe të tjera	474,302	863,350
Shpenzime të tjera	(14,472,183)	(2,945,308)
Fitim/humbje nga kursi	0	0
Vlera e mbetur e AAM	(410,768)	(6,140,166)
Totali	106,070,218	96,245,245

Shpenzimet kapin shifrën **535,695,375** lekë, ndërsa të ardhurat **536,463,735** lekë. Rezultati që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj gjatë këtij viti ushtrimor është **768,360** lekë fitim.

- Të ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit janë rritur me 5.65 % në krahasim me vitin e kaluar, për arsye të hapjes së kontratave të reja . Në të ardhurat e tjera janë përfshirë rimarrja e granteve për investime ,kamatë vonesat dhe trifat e mbledhjes së taksës së Bashkise (1%)

Shpenzimet për **535,695,375** lekë, janë të justifikuara me dokumenta të rregullta fiskale. Më konkretisht shpenzimet sipas zërave janë si më poshtë :

Shpenzime për mallra dhe shërbime kapin shifrën 242,009,385 lekë, ato janë përdorur për veprimtarinë kryesore të shoqërisë, këto shpenzime janë të justifikuara me dokumenta.

Shpenzime materiale për 41,211,740 lekë paraqesin :

- shpenzime karburanti për 5,644,148 lekë,
- shpenzime klori për 3,096,580 lekë,

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Fier”.

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2018

- shpenzime hidraulike për 7,449,253 lekë
- shpenzime për KUZ 1,676,946 lekë
- shpenzime të tjera për automjetet 1,464,701 lekë,
- shpenzime kancelari për 2,199,529 lekë,
- shpenzime për materiale të ndryshme 19,680,583 lekë
- **Shpenzime të tjera** paraqesin :
 - shpenzime për energji elektrike 162,383,232 lekë
 - shpenzime për telefon e shërbim postar dhe internet per 1,351,910 lekë
 - shpenzime per mirëmbajtjen e programit All-Billing 760,000 lekë
 - shpenzime të tjera 3,285,444 lekë
 - shpenzime për mirëmbajtjen e programit Bilanc 39,399 lekë
 - shpenzime për mirëmbajtje, riparime elektromotorrë etj 5,174,491 lekë ,
 - shpenzime për siguracione automjesh + kontroll teknik 728,000 lekë
 - shpenzime për taksa dhe tarifa vendore 323,470 lekë,
 - shpenzime për reklama dhe publicitet 5,000 lekë
 - shpenzime për gjoba dhe dëmshpërblime 4,622,325 lekë
 - shpenzime për klient familjar(debi) 9,289,008 lekë
 - shpenzimet për taksa tarifa për entin rregullator të ujit në shumën 7,012,662 lekë ,
 - komisione dhe garanci banke 104,347 lekë ,
 - shpenzime për rojet e objekteve dhe arkat për 18,560,521 lekë. Këto shpenzime justifikohen me dokumenta.
 - këshilli administrativ + trajnime të ndryshme për shumën 679,960 lekë
 - shpenzime për udhëtime e dieta 406,814 lekë,
 - Uji i blerë për njësinë Administrative Cakran 4,458,960 lekë

Personeli, në këtë llogari janë pasqyruar shpenzimet për paga 157,307,859 lekë, sigurime shoqërore 26,523,208 lekë, listëpagesat janë përpiluar saktë dhe shpenzimet për paga e sigurime janë vendosur korrekt në këtë llogari.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TE SHOQERISE

“Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Fier”.

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31 Dhjetor 2018

Amortizimi me vlerë 70,559,147 lekë nuk kalon kufijtë e fiskut.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzime interesi për huatë 14,472,183 lekë

Rezultati ushtrimor neto që ka realizuar shoqëria nga veprimtaria e saj është 786,360 lekë.

Me gjendjen e saj financiare Shoqëria ka qenë në gjendje të likujdojë rregullisht pagat, sig.shoqerore, blerje materiale, pjeserisht energjinë elektrike. Për të shlyer detyrimet kreditore ne duhet të arkëtojmë kerkesat debitore që do çojnë në rritjen e gjëndjes financiare,prandaj ne parashtrijmë hartimin e një programi masash i cili synon :

- Evidentimin e debitoreve sipas grup konsumatoreve.
- Evidentimin e klienteve te cilen kanë furnizim uji por nuk kanë kontrate me Ujësjetllësin.
- Grupi taskforcës te jetë më efektive në marjen e masve për debitorët që nuk shlyejnë detyrimet deri në ndërprerjen e lidhjeve të ujit.
- Pas akt-rakordimeve me subjektet shtetore e private në rast të mos shlyerjes së detyrimit të ndiqen procedurat ligjore deri në zyrën e përmbarimit.
- Vendosija e penalteteve sipas ligjeve.
- Rritja e nivelit te arkëtimeve në 90% për faturat koherente per 6-mujorin e I-rë / 2019.
- Regjistrimi i asetëve të marra nga Bashkia Fier pas reformës administrativo-territoriale sipas procesverbaleve te marrjes ne dorezim te pasqyruar dhe ne raportin e ekspertit kontabel si dhe procedurat per shtimin e kapitalit ne QKB.
- Saktësimi i gjëndjes fizike me atë kontabel te AAM
- Të bëhet saktësimi dhe shkarkimi nga programi Al-Billing i klientëve të cilët kanë paguar rregullisht detyrimin për ujin dhe në fakt figurojnë debitorë.
- Te shikohet mundësia e ujlës së shpenzimeve në zërat kryesorë si : energji elektrike , shpenzime për materiale/ shërbime.
- Hapja e tre puseve të rinj dhe zvendësimi gradual i pompave ekzistuese me ato të teknologjive të reja që kanë konsum më të ulët të energjisë elektrike.

Për Drejtorinë Tregëtare
Flamur ZAIMI



ADMINISTRATORI
Piro NDREU



